



PËRMBLEDHËSE E DËGJESËS PUBLIKE “Plani i Veprimit të Zhurmave në Mjedis” BASHKIA SHKODËR.

Bazuar në Ligjin nr.9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, Udhëzimit të Ministrit të Turizmit e Mjedisit Nr. 1 datë 19.02.2018 “ Për miratimin e kërkesave minimale për hartimin e Planit të Veprimit për zhurmat”, Bashkia Shkodër/Drejtoria e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, organizoi sot me datë 05.03.2019 ora 10:00 dëgjesën publike për **Planin Lokal të Veprimit të Zhurmave në Mjedis**, takim i zhvilluar në ambientet e Bashkisë Shkodër, Salla e takimeve.

Takimi filloi sipas Rendit të ditës i cili ishte bërë publik , në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër.

[http://www.bashkiashkoder.gov.al/Këshillim me Publikun /](http://www.bashkiashkoder.gov.al/Këshillim%20me%20Publikun/) [Njoftim për dëgjesë me publikun për “ Planin lokal për veprimin e zhurmave në mjedis”.](#)

Në dëgjesë ishin të pranishëm përfaqësues të Universitetit “Luigj Gurakuqi”, përfaqësues të shoqatave mjedisore, Drejtorisë Rajonale të Mjedisit, specialistë të drejtorisë së Planifikimit Strategjik, Drejtorisë së Turizmit, Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit të Bashkisë Shkodër. Përfaqësuesit i falenderoi për pjesëmarrjen z. Arben Gjuraj zv/Kryetar i Bashkisë.

Dëgjesën e hapi Kryetarja e Bashkisë zj. Voltana Ademi e cila mbasi përshëndeti pjesëmarrësit, vlerësoi punën e bërë nga grupi teknik për materialin e përgatitur duke vënë theksin në faktin që ky është Plani i parë që hartohet dhe përmbledh shumë aktorë të rëndësishëm për të qenë pjesë e zbatimit dhe monitorimit të tij. Kjo vihet re edhe në Matricën e aktiviteteve , atë të miratimit si edhe Tabeala e kostove referuar ndërhyrjeve të propozuara.

Më pas u kalua në një përmbledhje të Planit Lokal të Veprimit të zhurmave në mjedis Vizionit të tij dhe Objektivave të bëra nga zj. Aida Shllaku.

Materiali i prezantuar përmbante :

- 1.Qëllimin e hartimit të planit
2. Çfarë është zhurma dhe treguesit e saj
3. Vlerësimi i situatës ekzistuese
4. Metodologjia e punës
5. Ndërhyrjet për reduktimin e zhurmës/ndotjes akustike
6. Plani i veprimit.

Materiali i paraqitur ishte përpunuar në harta në format gis si edhe në jpg, të cilat u paraqitën për audiencën.

Vemë në dukje se i gjithë materiali, ishte i aksesueshëm për publikun, në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër, prej rreth 25 ditë përpara se të zhvillohej Dëgjesa Publike.

Aktualisht ky material vazhdon të jetë i publikuar në këtë faqe ku edhe mbas kësaj dëgjesë të interesuarit të mund të marrin informacionin e kërkuar dhe njëkohësisht të paraqesin observacionet/ vlerësimet e tyre.

Mbas kësaj u kalua në pyetje dhe diskutime.

Zj.Aurora Dibra vlerësoi punën e bërë nga Bashkia Shkodër dhe njëkohësisht ofroi kontributin e saj për të qënë pjesë e vazhdimësisë së këtij plani.

Z. A.Gjuraj garanoi të pranishmit që vërejtjet apo sugjerimet e tyre do të mërreshin në konsideratë dhe kërkoi mirkuptimin e tyre që të biem dakord për parimet e këtij plani.

Takimin e mbylli zj. A. Shllaku e cila falenderoi të gjithë pjesëmarrësit për mendimet e tyre, njëkohësisht ftoi të pranishmit dhe jo vetëm që të jenë pjesë aktive e këtij procesi të rëndësishëm dhe Bashkia është e hapur për të gjitha vërejtje/ sugjerime/opinione që do të paraqiten.